

VENDIM
Nr. 70, datë 27.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSVE CIVILË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 9, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Shkronja "gj" ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"gj) Një përfaqësues i qeverisjes vendore, që është nëpunës civil i organeve të qeverisjes vendore, i propozuar nga shoqatat e qeverisjes vendore dhe i zgjedhur nga ministri përgjegjës për çështjet vendore."

b) Pas shkronjës "gj" shtohet shkronja "h", me këtë përmbajtje:

"h) Drejtori i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)."

2. Në pikën 7, pas fjalëve "... dhe "e" ..." shtohen fjalët "... dhe "h"..."

3. Pika 1, e kreut II, ndryshohet me këtë përmbajtje:

"1. Buxheti i ASPA-s është zë i veçantë në programin e miratuar për administratën publike në buxhetin e shtetit."

4. Në pikën 4, të kreut IV, fjalët "... jo më shumë se një muaj..." zëvendësohen me fjalët "... jo më shumë se tre muaj..."

5. Në kreun V bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pika 2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"2. Trajnimi jashtë vendit, i organizuar nga institucioni, është me shkëputje nga puna. Gjatë periudhës së trajnimit deri në tre muaj, nëpunësi merr pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune."

b) Në pikën 3, fjalët "... që kalon një muaj..." zëvendësohen me fjalët "... që kalon tre muaj..."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama